



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.982/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses G.A. nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.A., avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.810/20, të datës 07.09.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 17.03.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e së paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.810/20, i datës 07.09.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.810/20, të datës 07.09.2020, ka vendosur:

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses G.A. nga Prishtina.

I.DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit Prishtinë, që paditëses G.A. nga Prishtina, në emër të shpërblimit për një pagë jubilarë t’ia paguaj shumën prej 225.76 € dhe për shujtat ushqimore shumën prej 804 €, me kamatë ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II.DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 259 €.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja G.A. nga Prishtina, me dt. 19.02.2020, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, e cila me anë të precizimit të kërkesëpadiës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 13 vite të përvojës së punës, t'ia njoh shumën prej 225.76 € si dhe në emër të shujtave ditore gjatë ditëve të punës për 402 ditë pune, duke llogaritur prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020 nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, t'ia kompensojë shumën në lartësi prej 804 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 259€.

E paditura, si në përgjigje në padi ashtu edhe gjatë shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje juridike, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.810/20, të datës 07.09.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga provat e administruara gjykata gjeti se kërkesëpadia është e drejtë dhe e bazuar në ligj sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua fakti se paditësja është duke punuar tek e paditura me kontratë pune për kohë të pacaktuar, se e njëjta ka mbi 10 vite përvojë pune dhe të njëjtës nuk i është paguar shpërblimi jubilar në lartësi prej 50% të një page bazë, bazuar në nenin 35 par.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, e cila kontratë në kohën kur paditësja ka fituar kushtin për kompensimin e pagave jubilarë ka qenë në fuqi. Po ashtu, në nenin 35 par.7 të kësaj Kontrate është paraparë pagesa e shujtës së ushqimit për punëtorët, për ditët e prezencës në punë, në lartësi prej 2 Euro për ditë andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitën e lartë cekur ka vlerësuar se paditëses i takon e drejta e kompensimit në emër të shujtës për ushqim për çdo ditë të qëndrimit në punë, gjithsej për 402 ditë pune, duke e llogaritur nga data 18.04.2017 e deri me datën 11.03.2020. Vendimin mbi kamatën, gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në nenin

382 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t'paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin nuk është kontestues fakti që paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU "Ismail Qemali" në Prishtinë, në pozitën e Mësimdhënëses Klasore, fakt ky i cili vërtetohet në bazë të kontratës së punës për stafin arsimor, me nr. 03 344/14.03.2016 dhe nr. protokollit 110, e datës 01.09.2010. Po ashtu, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga SHFMU "Ismail Qemali" me nr.439/2020 të dt. 31.08.2020 vërtetohet se paditësja ka përvojë pune prej 13 vite. Lidhur me ditët e prezencës në punë, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga SHFMU "Ismail Qemali", me nr.445 e dt. 07.09.2020, është vërtetuar fakti se paditësja në periudhën kohore 18.04.2017-11.03.2020 ka qenë prezentë në vendin e punës për 402 ditë pune. Nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagës që paditësja e ka realizuar tek e paditura, fakt ky i vërtetuar edhe nga lista e pagave, në bazë të së cilës provë vërtetohet se paditësja ka realizuar pagë mujore në shumën prej 451.52 Euro.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragrafin 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve"*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes"*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës"*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive..."*.

Me nenin 35 paragraf 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti ”.* Në paragrafin 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.*

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të padisë në këtë çështje juridike, pra shërben si Akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragrafin 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të t’ paditurës lidhur me faktin se e njëjta nuk mund të obligohet në raport me përmbushjen e detyrimit ndaj paditëses, me arsyetim se nuk është ndarë linjë e veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit, megjithatë vlerëson se çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së dhe se veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.982/21, me datë 17.03.2022.

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka d.v.